



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:137200

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05824726

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh H., për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë PP/II.nr. 759/23 të datës 16.06.2023 të pranuar në gjykatë me datën 19.06.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë 14.06.2024, në ë prani të Prokurorit së shtetit Qazim Kuqi dhe të akuzuarit të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **XH. H.**, data e lindjes . . ., në Gjakovë, ku edhe tani banon, Rr. “. . .”, banesa përball gjykatës në emër të M.R., i biri i M. dhe i B., e gjinisë I., ka të kryer klasën e parë të shkollës fillore, i pa punë, ë bashkë jetesë atë i 2 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike- me ndihma sociale, me nr. personal . . ., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës

Ë s h t ë f a j t o r e

Sepse :

- Me datë 04.06.2023, rreth orës 16:54, në Rr. “UÇK”, në Gjakovë, respektivisht në hyrjen e banesës së të dëmtuarit V.T., i pandehuri Xh. H., me qëllim që vetes t’i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, ia merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit dhe atë një biçikletë ngjyrë hiri, në atë mënyrë që, i pandehuri duke e shfrytëzuar momentin e volitshëm derisa nuk po vërehet nga askush, në vendin e lartcekur, e merr biçikletën, e cila biçikletë nuk ishte e siguruar me çelës dhe pa u vërejtur nga askush largohet nga aty, me ç`rast të dëmtuarit i shkakton dëm material në vlerë rreth 100 euro-

-me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK-së .

Gjykata në bazë të neni nenit 2, 3 par.1, nenit 4, 6, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43,46,47,48,49 par. 5, 69, 70, 71 par.1 nën. par.1. dhe par.3 nenit 313 par.1, të KPRK-së, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të akuzuarës i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **150 (njëqind e pesëdhjetë) ditësh si dhe dënim me gjobë në shumë prej 100 (një dyqind) euro, të cilat** dënime nuk do të ekzekutohen nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një)viti** , nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet .

I dëmtuari V.T. nga Gjakova ,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civile juridik .

Shpenzimet e procedurës penale bien ne barrën e mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr. 759/23 të datës 16.06.2023 të pranuar në gjykatë me datën 19.06.2023., ka akuzuar të akuzuarin Xh. H. nga Gjakova, për shkak te veprës penale te vjedhjes nga neni nga neni 313 par. 1 të KPRK-së .

Gjykata konstaton se me aktvendimin P.nr. 2023:137200 të datës 28.08.2023.11.2023, ka pezulluar mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me qenë se i akuzuari Xh. H. , nuk ka marr pjesë ne seancat e caktuar për te cilin është lëshuar urdhëresë për shoqërim me detyrim nga st. Policor në Gjakovë , të cilët sipas njoftimit me nr. ref. 04/1-08-Gj-S-185/23 të dt. 25.08.2023, jemi njoftuar se është kërkuar në adresën e dhënë por nuk është gjetur, me pas është verifikuar në bazë e të dhënave policore SIPK ku rezulton ti ketë dy adresa Rr. ”. . ” dhe Rr. ”. . ”, në këto dy lokacioni është kërkuar por nuk është gjetur, janë gjetur një numër te [tel:. . .](#), ku pas kontaktit me këtë numër del se është krejt tjetër person, sipas informatave që kanë ky person banon nëpër vendet e ndryshme dhe nuk ka adresë të saktë, andaj për te njëjtin ka lëshuar edhe urdhër arrest.

I akuzuari Xh. H. është paraqitur ne gjykatë pasi qe i njëjti është ndaluar nga st. policor lidhur me urdhër arrestin e lëshuar nga ane e gjykatës me datë 13.06.2024 ,dhe i njëjti është paraqitur në gjykate sot me dt. 14.06.2024, i njëjti do të procedohet dhe gjykata benë tërheqja e urdhër arrestit.

Prokurori i shtetit Azem Islamaj , në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datën 14.06.2024, lexon aktakuzën PP/II.nr. 759/23 të datës 16.06.2023 dhe deklaron se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuari pasi qe ky pranim i fajësisë është bere në mënyrë vullnetare dhe pa presion ,duke i ditur pasojat dhe benefitet e pranimit te tillë , pranim është bere pas sqarimit të mjaftueshëm nga ana e gjykatës, po ashtu faktin se pranim i fajësisë mbështet në faktet e çështjes ,respektivisht provave materiale dhe personale qe përmban aktakuza.. Lidhur me vendimin për dënim i propozon gjymtës qe si rrethana lehtësuese te merret pranimin e fajësisë për veprën penale me te cilën akuzohet , ndërsa si rrethanë renduese të këtë parasysh shkallen e lartë te dashjes .

I akuzuari Xh. H. , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë , deklaron e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i njëjti lidhur me fajësinë deklaron: se ndihem fajtor për veprën penale me te cilën pandehem sipas aktakuzës duke i ditur edhe me parë pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë , shtoj se me pranimin e fajësisë ne çdo fazë te procedurës jam penduar për veprën e kryer për shkak te gjendjes ekonomike, , jetojë me ndihma sociale dhe jam mbajtësi familjes prej 5 anëtarësh , asnjëri nga ata nuk punon , fëmijët janë te mitur , kërkojë faljen për veprimet e mija edhe pse biçikletën e kam kthyer ne st. policor , andaj gjykatës i propozoi qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se një veprim i tillë nuk do

te përsëritet ,kthimi i gjësendeve te dëmtuarit , kërkim falje publike në gjykatë, të më shqiptojë një dënim me të butë . Lidhur me vendimin për dënim deklaroi se jam i pa punë , banojë me qira në banesën e M.R., përball gjykatës ,jetojë ne bashkësi familjare prej 5 anëtarëve dhe mbajtës i familjes, gjendjen e dobët ekonomike- ndihma sociale, me parë kam qene i dënuar për vepra të natyrës se njëjte .

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarit Xh. H. , është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pas sqarimit të mjaftueshëm edhe nga ana e gjykatës , pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike: se i akuzuari Xh. H. , me dashje ka kryer veprën penale te vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK-së, në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 313 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të vjedhjes e kryen: *“Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej (50) euro apo më shumë , me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër , dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre(3) vjet.*

5. Vendimet e gjykatës

Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore të lart cituara, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, konsumohen të gjitha tiparet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, pasi është vërtetuar se e akuzuari ditën kritike ka kryer veprën penale të vjedhjes , siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 69,70 dhe 71 paragraf 1 nën paragraf 1.3 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti personalitetin e të akuzuarit se është baba i 2 fëmijëve , i pa punë i gjendjes së dobët ekonomike - me ndihma sociale , pranimin e fajësisë të cilën e ka bërë në çdo fazë të procedurës , është penduar shumë për veprën e kryer me ç ‘rast edhe i është kthyer të dëmtuarit biçikleta , ka shprehur keqardhje për veprimet e veta, të dëmtuarit i ka kërkuar edhe falje publike, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt ,premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme të natyrës së njëjtësi dhe fakti se sipas Evidencës penale të gjykatës i lartpërmenduri: nuk gjendet ne evidencën penale të personave të

dënuar. Ndërsa sa i përket rrethanave rënduese, Gjykata konsideron faktin se e njëjti ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata sipas bindjes së saj vlerësoi se shqiptimi i dënimit me burg në kohëzgjatje prej 150(njëqind e pesëdhjetë) ditësh si dhe dënim me gjobë në shumë prej 100 (njëqind)euro , të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse e akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(një) viti , nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do të kryen vepër tjetër penale e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet ,ky dënim është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së tij (nën ndikimin e narkotikëve) dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i tij, i paraparë në nenin 38 dhe 47 të KPRK-së, i cili konsiston me parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprës penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata, duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-së , ka vendosur që të dëmtuarin V.T., për realizimin e kërkesës pasurore juridike ti udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, të kërkesës pasurore juridike .

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri në mbështetje të nenit 453/4 të KPP-së ,pasi që është i gjendjes së dobët ekonomike – sfrytëzues i ndihmave sociale e detyrimi që ti paguaj shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit ose të personave që ai detyrohet ti mbështes materialisht.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
2023:137200 më datë 14.06.2024**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **30 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.